VENDIM
Nr.786, datë 26.11.2003

PËR KOMISIONIMIN DHE PAGESËN PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 37 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", i ndryshuar dhe të nenit 121 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjithë personat e lindur me aftësi të kufizuar ose që janë bërë të tillë para moshës 21 vjeç dhe deri në moshën 24 vjeç, kur ndjekin arsimin e lartë, kur paaftësia e tyre vërtetohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësive për Punë (KMCAP), përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar.

2. Vlerësimi i gjendjes mjekësore të personave me aftësi të kufizuar për punë bëhet nga KMCAP-i, i cili është ngritur dhe funksionon pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në këtë komision merr pjesë, si anëtar me të drejtë vote, edhe mjeku, punonjës i Shërbimit Social Shtetëror.

3. Pagesa për personat që përfitojnë paaftësinë bëhet një herë në muaj dhe fillon në muajin pasardhës, pas daljes në komision.

4. Pagesa për aftësinë e kufizuar është 6000 (gjashtë mijë) lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi.

5. Personat që përfitojnë nga pika 1 e këtij vendimi, për periudhën që ndjekin arsimin e mesëm, marrin dyfishin e pagesës, ndërsa për periudhën që ndjekin një cikël të plotë të arsimit të lartë ose pasuniversitar marrin trefishin e pagesës së përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi. Ky përfitim shtesë nuk merret për periudhën e pushimeve të vitit shkollor.

Personat me aftësi të kufizuar e përfitojnë pagën shtesë edhe në rastet kur studimet zgjasin edhe një vit më shumë se sa kohëzgjatja normale e ciklit të shkollës.

6. Përfitimi për aftësinë e kufizuar vlerësohet si e ardhur personale dhe nuk përfshihet në të ardhurat e familjes, për efekt të llogaritjes së ndihmës ekonomike.

7. Personat me aftësi të kufizuar, për sa kohë që hyjnë në marrëdhënie pune apo vendosen në qendra rezidenciale të riaftësimit publik, e humbasin të drejtën e përfitimit.

8. Personat që marrin pagesë për aftësi të kufizuar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, dhe që nga KMCAP-i janë klasifikuar si persona që kanë nevojë për përkujdesje të pandërprerë, marrin edhe pagesën për një kujdestar, kur familja e tyre nuk ka të ardhura. Kujdestari mund të jetë anëtar i familjes ose një i zgjedhur nga vetë personi me aftësi të kufizuar. Masa e përfitimit të kujdestarisë është 5000 (pesë mijë) lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi.

9. Shpenzimet për pagesën e anëtarëve të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësive për Punë (KMCAP) përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përveç pagesës së mjekut anëtar, punonjës i Shërbimit Social Shtetëror.

10. Në Shërbimin Social Shtetëror shtohen 15 punonjës (mjekë) për realizimin e procedurës së re për komisionimin e personave me aftësi të kufizuar.

11. Fondi prej 8 000 000 (tetë milionë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2004, fondi për pagesën e personave me aftësi të kufizuar, i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

12. Ngarkohet Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

13. Vendimi nr.311, datë 11.7.1994 i Këshillit të Ministrave "Për përfitimin e paaftësisë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga 1 janari 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano